

Kontratë Dhurimi

Sot më datë 21 / 10 /2019 u paraqitën për të lidhur këtë kontratë palët e mëposhtme

Palët pjesëmarrëse në kontratë

Dhuruesi Z. ErdiSinani me zotësi të plotë juridike për të vepruar .

Përfituesi Z. Elton Musa me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Objekti I Kontratës

Objekti I kësaj kontrate dhurimi i 50% te kuotave të kapitalit të shoqërisë të cilat i përkisnin z.ErdiSinani, me heqjen dorë vullnetarisht prej tij të shpërndahen në formë të tillë si: 50% të kuotave tek Z. Elton Musa, duke e kaluar statusin e Z. Elton Musa si pronar i 100% te kuotave.

Palët me marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me nenet 761 e vijues të Kodit Civil.

Vendosën

Të lidhin këtë kontratë në kushtet e mëposhme :

Qëllimi

Neni 1

Qëllimi I kësaj kontrate është kalimi pa kundër shpërbllim të pronësisë, objekt I kësaj kontrate nga dhuruesi tek përfituesi të cilen ky I fundit e pranon.

Afati I dorëzimit të pronësisë

Neni 2

Dorëzimi i 50 % së aksioneve të cilat i përkisnin z.ErdiSinani do të bëhet menjëherë mbas nënshkrimit të kësaj kontrate tek ortaku tjetër Z. Elton Musa. duke e kaluar statusin e Z. Elton Musa si pronar i 100% te Aksioneve te shoqerise EMS Group Albania Shpk.

Të drejtat dhe detyrat e dhuruesit

Neni 3

1. Dhuruesi merr përsipër të garantojë përfituesin për përkatësinë e objektit të kësaj kontrate.



2. Dhuruesi duhet të dorëzojë objektin e kontratës në kohën e përcaktuar sipas nenit 2 të kësaj kontrate.

Pranimi I përfituesit

Neni 4

Pranuesi I objektit të kontratës vendos të pranojë dhurimin.

Sanksionet

Neni 5

Dhuruesi detyrohet të përmbushi detyrimet e parashikuara në këtë kontratë përndryshe përgjigjet sipas dispozitave të Kodit Civil.

Shpenzimet e lidhjes së kontratës

Neni 6

Në marrëveshje midis palëve shpenzimet e lidhjes së kontratës I takojnë përfituesit.

Hartimi I Kontratës

Kjokontratë u hartua në katër kopje ku një nga to e marin secila nga palët pjesëmarrëse. Pasi u lexua, u nënshkrua nga secili prej tyre në vullnet të plotë e të lirë.


Lidhja e kontratës

Kjo kontratë do të quhet e lidhur në momentin që do të behet kalimi I të drejtave të % së kuotave tek secili përfitues.

Palët Kontraktuese

Dhuruesi

Erdi Sinani

Erdi Sinani




Perfitues

Elton Musa

E. L. Musa
